

VENDIM
Nr. 68, datë 2.2.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR HAPJEN E PIKËS SË
PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR SHISHTAVEC (KUKËS)–KRUSHEVË
(DRAGASH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shishtavec (Kukës)–Krushevë (Dragash), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MARRËVESHJE NDRYSHUESE
E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR
KRUSHEVË (DRAGASH)–SHISHTAVEC (KUKËS)

Këshilli i Ministrave i Republikës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim “palët nënshkruese”), më 16 prill 2013 kanë lidhur Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Krushevë (Dragash)–Shishtavec (Kukës). Nisur nga vullneti i mirë për të forcuar dhe për të avancuar më tej bashkëpunimin, zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, palët hynë në ndryshimin numër një të kësaj Marrëveshjeje, i cili bën ndryshimin në kategorizim të pikës së përbashkët të kalimit kufitar nga kategoria C në kategorinë B.

Palët kanë rënë dakord të ndryshojnë Marrëveshjen, si më poshtë:

Neni 1

Neni 1 i Marrëveshjes ndryshohet, si në vijim:

“Palët bien dakord për të ngritur nivelin e organizimit dhe të funksionimit të Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Shishtavec–Krushevë (në vijim “PPKK”) në kategorinë B.

PPKK-ja do të punojë në orar 24/7 për trafikun kufitar të udhëtarëve, mjeteve dhe mallrave jokomerciale.

Objekti i ri i PPKK-së do të ndërtohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, në vendin e quajtur Shishtavec.”.

Neni 2

Nenit 2 të Marrëveshjes bazë i shtohet një paragraf i ri, si në vijim:

“Ngarkohet Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve (në vijim “KPE”) që të caktojë vendndodhjen e objektit të përkohshëm të PPKK-së, e cila do të funksionojë deri në përfundimin e ndërtimit të objektit të ri të PPKK-së.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si në vijim:

Palët bien dakord në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet KPE-së, të nënshkruajnë protokolle të reja zbatimi, në të cilat do të përcaktohen çështjet teknike, financiare dhe të organizimit, që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe me funksionimin e PPKK-së.

Neni 4

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e të dyja palëve nënshkruese, përmes shkëmbimit të notave verbale.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes, përmes kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët vënë në dijeni njëra-tjetrën se kanë përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacionet e shteteve të tyre, për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në dy origjinale, secila në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njëlloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të këtë përparësi teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Z. Bledar Çuçi
Ministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Z. Xhelal Sveçla
Ministër i Ministrisë
së Punëve të Brendshme